

Në bazë të neneve 17 e 18 të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Ligji nr.2004/19) dhe neneve 20, 21, 25 dhe 35 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kryesia e Akademisë në mbledhjen e saj të dt. 23 maj 2012, vendosi të shpallë

QARKOREN
MBI PROPOZIMIN E KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË RREGULLT DHE KORRESPONDENTË TË
AKADEMISË

Duke pasur parasysh karakterin dhe rolin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rastin e dhënies së propozimeve është e domosdoshme të merren parasysh posaçërisht këto momente:

Me nenin 25 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është paraparë që propozime të arsyetuara për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë mund të japin: **seksionet e Akademisë, këshillat shkencorë-mësimorë të fakulteteve dhe këshillat shkencorë të instituteve shkencore publike që financohen nga buxheti i Kosovës.** Në mbledhjet e organeve përkatëse të institucioneve, që me Statut janë të autorizuar të japin propozime, duhet të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme çështja se cilët shkencëtarë, respektivisht artistë i plotësojnë kushtet për t'u propozuar anëtarë të Akademisë, në mënyrë që, në bazë të rezultateve të shqyrtimit dhe të vlerësimit të krijimtarisë shkencore a artistike të kandidatëve, të paraqiten propozimet e arsyetuara për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Me nenin 17, alinea 3 të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, përkatësisht me nenin 20 alinetë (3) dhe (4) të Statutit të ASHAK është precizuar se:

(3) “Anëtar i rregullt i Akademisë - akademik zgjidhet punonjësi i shquar i shkencës dhe i arteve, shtetas i Kosovës, i cili jeton dhe vepron në territorin e Kosovës, rezultatet e punës të të cilit paraqesin realizime kulmore në fushën e shkencës dhe të arteve me peshë në vend dhe jashtë tij.

(4) Anëtar i rregullt mund të zgjidhet anëtari korrespondent rezultatet e punës së të cilit që nga zgjedhja anëtar korrespondent paraqesin një arritje të lartë në fushën e shkencës ose të arteve dhe që gëzojnë një njohje të përgjithshme”.

Me nenin 18 të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, përkatësisht me nenin 21 të Statutit të ASHAK është precizuar se:

“Anëtar korrespondent zgjidhet punonjësi i dalluar i shkencës a i arteve, shtetas i Kosovës, që jeton dhe punon në territorin e Kosovës, dhe që ka krijuar vepra shkencore a artistike të një rëndësie të veçantë”.

Propozimet duhet të jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë veçanërisht:

- të dhënat e hollësishme për punën shkencore ose për veprat artistike të kandidatit të propozuar.
- vlerësimet e plota të propozuesve mbi rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.
- të dhënat mbi recensionet e mëparshme për rezultatet e krijimtarisë shkencore dhe artistike të kandidatit të propozuar.

Në procedurën e dhënies së vlerësimeve mbi krijimtarinë e kandidatëve, organet përkatëse të institucioneve, që me Statut janë të autorizuar të japin propozime për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, mund të angazhojnë edhe punonjës të dalluar të shkencës e të artit dhe institucione jashtë mesit të tyre.

Propozimet e arsyetuara duhet t'i dërgohen Kryesisë së Akademisë deri më 5 shtator 2012 në adresën: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, rruga **Agim Ramadani**, pa nr.

Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë këtij afati nuk do të merren parasysh.

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS